



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETI DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1283 Prot.

Tiranë, më 26/07 2021

Deklaratë për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të ministrisë së arsimit sportit dhe rinisë për vitin 2020

Unë i nënshkruari Alqi Kushi, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe të koordinatorit të riskut të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, deklaroj se kam përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo-financiare të njësisë, si dhe pohoj që sistemi i kontrollit të brendshëm, i ngritur nga Titullari i Njësisë, mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë, në përputhje me përgjegjësitë që më janë caktuar sipas nenit 9 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues deklaroj se kam monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë gjatë vitit raportues 2020, nëpërmjet:

- Koordinimit të takimeve me drejtorët e drejtorive në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut.
- Këshillimit dhe dhënies së instruksioneve menaxherëve të tjerë të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- Paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe tek Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të Ministrisë.


Deklaroj nën përgjegjësinë time se raporti bashkëlidhur kësaj deklaratë, pasqyron në mënyrë të besueshme efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përfshin plan veprimin për trajtimin e mangësive të vërejtura në sistem për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

NËPUNËS AUTORIZUES

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

ALQI KUSHI



Shënim; Z. Alqi Kushi është emëruar në pozicionin e Sekretari i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 260., prot, 4128, datë 29.7.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë "Ngarkim i përkohshëm në detyrë". Me shkresën nr. 14742/1, datë 17.08.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratohet Nëpunës Autorizues për fondet e MASR. Me shkresën nr. 3344/1, datë 29.07.2020 të Departamentit të Administratës Publike Z. Oltjon Muzaka, lirohet nga detyra e Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë. Me shkresën. nr. 4080/3, datë 07.08.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Z. Oltjon Muzaka, mbyllet si përdorues Nëpunës Autorizues për Sistemin Informatikë Financiare të Qeverisë SIFQ. Me shkresën. nr. 4080/4, datë 07.08.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Z. Alqi Kushi, miratohet si përdorues, Nëpunës Autorizues për Sistemin Informatikë Financiare të Qeverisë SIFQ. Me Urdhrin nr. 261., prot, datë 30.7.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, "Për delegim kompetencash", Z. Alqi Kushi, i delegohen kompetencat e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në zbatim të ligjit të Prokurimit Publik.

Z. Alqi Kushi është emëruar në pozicionin e Sekretari i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 299., prot, 5247 datë 01.10.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë "Ngarkim i përkohshëm në detyrë". Me Urdhrin nr. 300., prot 5366, datë 07.10.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Z. Alqi Kushi, i delegohen kompetencat e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në zbatim të ligjit të Prokurimit Publik, të përcaktuara në nenin 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 "Kodi i procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", si dhe në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik". Urdhri nr. 261., prot, datë 30.7.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, "Për delegim kompetencash", shfuqizohet.